AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike"**

**ofruar nga**

**Universiteti Privat "Albanian University"**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Dr. Frida GJERMENI**

**Prof. As. Dr. Oltion FOCIRO**

**Nëntor / 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti Privat "Albanian University" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Inxhinierive |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMASh Nr. 411, datë 25.08.2011 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | Vendim Senati nr.10, dt. 20.03.2019 dhe miratuar nga MAS me shkresë nr. 3784/1, dt. 06.06.2019. |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Nr. 393, Date 28.10.2020 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | VBA Nr. 42, datë 19.05.2017;<br>VBA Nr. 39, datë 13.07.2018 |
| 8 | Cikli i studimit: | cikli i parë bachelor |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite akademike |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohe të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 6 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | Viti 2018-2019 15 PAE/ 10 PAK<br>Viti 2019-2020 11 PAE /12 PAK<br>Viti 2020-2021 14 PAE /13 PAK<br>Viti 2021-2022 16 PAE /14 PAK<br>Viti 2022-2023 15 PAE /14 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | Viti 2018-2019 35<br>Viti 2019-2020 33<br>Viti 2020-2021 19<br>Viti 2021-2022 37<br>Viti 2022-2023 52 |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" ofrohet nga Departamenti i Inxhinierive pranë Institucionit të arsimi të larte, Universiteti Privat "Albanian University". Ky program është licencuar me Urdhër të Ministrise së Arsimit dhe Shkences Nr. 411, datë 25.08.2011. Në korrik 2018 (VBA Nr. 39, dt. 13.07.2018), rezulton të jete rikryer procesi i riakreditimit institucional. Akreditimi institucial është fituar me nje kohezgjatje prej 5 vitesh akademike.

Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" është program i ciklit të parë dhe sipas kuadrit shqiptar të kualifikimeve i përket nivelit të 6-të të kualifikimit. Kohëzgjatja e studimeve është 3 vjet, e përbërë nga 180 kredite ECTS. Programi ofrohet në gjuhën shqipe dhe studimet ndiqen me kohë të plotë.

Qëllimi i programit bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" është të krijojë bazat shkencore dhe përgatitjen teorike dhe praktike të nevojshme për një karrierë inxhinierike në fushën e shkencave kompjuterike ose në profile të krahasueshme te teknologjise se informacionit.

Gjate tre viteve të studimit në këtë program studimi, studentët krijojne një baze të mirëfilltë inxhinierike për zgjidhjen e problemeve në mënyre analitike me karakter informatik. Si rrjedhoje kjo ju jep mundesine e integrimit më të lehte në tregun e punës në vend, por edhe vazhdimit te studimeve me te thelluara ne programet e ciklit te dyte ne fusha te ngjajshme.

Viti i parë i studimeve në këtë program karakterizohet kryesisht nga lëndë formimi bazë duke vazhduar më tej me lëndë të formimit karakterizues e profesional në vitet më të larta të studimeve. Kurrikula e programit të studimit synon të jetë me lënde bashkekohore në mënyre që studentët të njihen me konceptet jo vetëm bazike por edhe më të avancuara inxhinierike.

Sipas specifikave të lëndëve studenteve u kërkohet edhe zhvillimi i detyrave të kursit apo projekteve ku synimi është aftesimi i tyre me punën në grup, por edhe zhvillimi i mendimit kritik në fushen inxhinierike e teknologjise së informacionit.

**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Grupi i vlerësimit të jashtëm është ngritur me urdhër të ASCAL nr. 124, datë 10.10.2023, pas kërkesës së IAL-së "Albanian University" në kuadër të akreditimit të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike". Ky grup përbëhet nga Dr. Frida Gjermeni dhe Prof. Asoc. Oltion Fociro. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Msc. Rajna Lila, Koordinatorja teknike e kësaj procedure.

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë përzgjedhur duke marrë parasysh kompetencat e tyre profesionale në lidhje me fushën e programit të studimit, përvojën në vlerësimin e programeve të studimit, integritetin profesional dhe mungesën e konfliktit të interesit për të siguruar paanshmëri dhe objektivitet në gjykim dhe vlerësim.

Në kuadër të hartimit të raportit, grupi ka vepruar me ndarje të qartë të punës, detyrave dhe përgjegjësive për secilin anëtar. Grupi ka shfrytëzuar "Raportin e Vlerësimit të Brendshëm", të hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm pranë Departamentit të Inxhinierisë në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, si dhe dokumentacionin e brendshëm të "Albanian University", përfshirë statutin, rregulloret dhe aktet e tjera rregullatore, rregulloren e Departamentit të Inxhinierisë dhe rregulloren e programit të studimit. Grupi i vlerësuesve të jashtëm u mbështet gjithashtu në të dhëna të tjera që lidhen drejtpërdrejt me këtë program studimi, si të dhëna statistikore dhe informacione të evidentuara në sistemin AMS të ASCAL. I gjithë informacioni i deklaruar nga IAL u verifikua gjatë vizitës vlerësuese të kryer pranë mjediseve të "Albanian University".

Grupi i eksperteve të jashtëm, së bashku me koordinatoren teknike të ASCAL, MSC. Rajna Lila, kreu viziten vleresuese pranë IAL-se në datat 18 dhe 19 Dhjetor 2023. Nga ana e IAL-së ishin marrë të gjitha masat për realizimin me sukses të vizites, në përputhje me axhendën e vizitës.

**SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT**

**I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 39, datë 13.07.2018 janë:**

1. Institucioni, të realizoje rekrutimin e stafit te ri akademik me kohë të plotë, me grada shkencore dhe tituj akademik, me qëllim uljen e ngarkesës mësimore të stafit akademik aktual dhe shpërndarje me efektive të lendeve/moduleve te ketij programi studimi.
2. Institucioni, te konsolidoje marreveshjet e bashkepunimit, me Institucione specifike te fushes se inxhinierise kompjuterike, me terma afatgjate, per realizimin e praktikave mesimore te studenteve te ketij programi studimi, ne nivel cilesor.
3. Institucioni, të mundesoje, në kuader të plotesimit të rekomandimit 1 sa me lart, përcaktimin e titullareve të lendeve nga stafi akademik me kohe të plotë.

**II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni**

Bordi i akreditimit përmes vendimit nr. 39 datë 13.07.2018 për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të pare, Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike", të IAL-ës Universiteti Privat "Albanian University" kan lënë rekomandimet si më poshtë:

1. Institucioni, të realizoje rekrutimin e stafit të ri akademik me kohë të plote, me grada shkencore dhe tituj akademik, me qëllim uljen e ngarkesës mësimore të

2. stafit akademik aktual dhe shperndarje me efektive te lendeve/moduleve te ketij programi studimi.

Institucioni ka bërë përpjekje për përmbushjen e këtij rekomandimi, duke shpallur dy here ne vit (ne fillim te vitit akademik dhe perpara fillimit te semestrit te dyte) nevojat për staf të ri akademik me tituj dhe grada shkencore, sipas specifikave të cdo programi studimi si dhe ka rekrutuar dy staf akademik por të cilat nuk kane as grade dhe as titull shkencor.

Gjithashtu, per t'i krijuar mundesi kualifikimi personelit akademik efektiv te departamentit, institucioni ka mundesuar financimin per pjesmarrje ne konferenca shkencore apo botime artikujsh ne revista shkencore.

Megjithe përpjekjet e bëra në këtë drejtim, ngarkesa e personelit akademik efektiv mbetet e larte si në orë mësimore edhe në modulet që mbulojnë.

***Rekomandimi nuk është plotësuar.***

3. Institucioni, të konsolidoje marreveshjet e bashkepunimit, me Institucione specifike të fushes se inxhinierise kompjuterike, me terma afatgjate, për realizimin e praktikave mesimore të studenteve të këtij programi studimi, në nivel cilësor.

Institucioni ka lidhur një sere marreveshjesh me aktore privat dhe shteteror në kuader të realizimit të praktikave mesimore. Ky fakt pasqyrohet edhe në raportin e GVJ. Nga ana

tjeter institucioni ka lidhur edhe një sëre marrveshjesh bashkepunimi me institucione homologe.

***Rekomandimi është plotësuar.***

4. Institucioni, të mundesoje, në kuader të plotesimit të rekomandimit 1 sa me lart, percaktimin e titullareve te lendeve nga stafi akademik me kohe te plote.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit që GVJ kreu vuri re se një pjese e mire e lëndeve të cilat përbejne programin e studimit vazhdojne të kene titullar lënde staf me kohe të pjesshme. Kjo vërehet edhe tek lëndët e formimit karakterizues të programit të studimit.

***Rekomandimi nuk është plotësuar.***

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike"**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | GVJ kontaton se bazuar në Statutin e Albanian University të gjtha programet e studimit të ofruara në këtë institucion janë në përputhje me interesat e prioritetet kombëtare në zhvillimin e teknologjise së Informacionit. Të gjitha programet e studimit synojne ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare sic edhe theksohet në Nenet 2/3 dhe 4 të këtij dokumenti.<br><br>*Referenca:*<br>*1.2 Statuti Albanian University* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Departamenti i Inxhinierisë në Albanian University ofron programe studimi të nivelit bachelor dhe master në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit, të fokusuara në fushën e Inxhinierisë Kompjuterike.<br><br>*Referenca:*<br>*1.2 Statuti Albanian University*<br>*1.3 Rregullore Albanian University* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar GVJ konstaton se Albanian University ka në themel të zhvillimit të tij si Institucion i arsimit të lartë ofrimin e programeve në përputhje me strategjinë e zhvillimit kombëtar të Republikes së Shqipërisë. Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit GVj konstaton se në rregulloren e këtij programi studimi në Nenin 4 citohet se ky program studimi zhvillohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit dhe strategjinë për zhvillim të tij.<br><br>*Referenca:*<br>*1.4.a Plani strategjik institucional 2017 - 2022*<br>*1.4.b Plani i masave Rektorati 2020 – 2021 për realizimin e objektivave strategjikë institucionalë - 2017 – 2022* |

| | |
|---|---|
| | *1.4.c Strategjia per zhvillimin institucional AU - 2023 – 2028*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019* |
| **Kriteri 4.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Institucioni Albanian University ka kapacitetet e duhura infrastrukturore dhe burimet njerezore të kualifikuar për ofrimin e këtij programi studimi me karakter inxhinierik. Përpos kësaj, ndër vite është fituar eksperienca e nevojshme akademike në përgatitjen e specialistëve të aftë në këto fusha.<br><br>*Referenca:*<br>*1.5 Përshkrimi i Laboratoreve të Departamentit të Inxhinierive.*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK. (Tabela 2, Tabela 6)* |
| **Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Bazuar në Rregulloren e FSHAE, në Nenin 1 të saj thuhet se Fakulteti i Shkencave të aplikuara dhe ekonomike është njësia kryesore e Albanian University, e cila ofron mësimdhënie dhe kërkim shkenor në fushat e shkencave ekonomike, inxhinierive dhe dizajnit. Ndërsa në rregulloren e Departamentit, në Nenin 4 të saj theksohet fakti se ky Departament grupon fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive.<br>Nga sa më sipër konkludojme se fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij program studimit përputhet me njësine kryesore e njësine baze që e ofron atë.<br>*Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe RVB, GVJ konstaton se Institucioni është në proces të kodifikimit të programeve ku bën pjesë edhe ky program studimi.*<br><br>*Referenca:*<br>*2.3 Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021*<br>*1.6 Rregullore FSHAE - 20.04.2022*<br>*RVB* |
| **Konkluzione** | *GVJ nga dokumentacioni i shqyrtuar, si edhe raporti i vleresimit të brendshëm të hartuar nga Institucioni konstaton se programi i studimit është në përputhje me statutin, rregulloren si edhe në fokus me strategjine e zhvillimit të Albanian University.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Standardi I.2**
**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Institucioni ka hartuar programin e diplomimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike duke u bazuar në bashkëpunimin midis strukturave akademike dhe administrative të vetë institucionit si dhe të stafit akademik të brëndshëm.<br>Po ashtu institucioni ka struktura të vecanta si për mbikqyrjen ashtu edhe për mbarëvajtjen e programit të studimit.<br>Në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm të programit të studimit, janë lidhur një sërë marrëveshjesh me institucione e kompani për zhvillimin e praktikave mësimore, por edhe bashkëpunim dhe partneritet në projektet lokale e kombëtare. Disa nga këto kompani janë NetCO, Bussines & Innovation Center, Deutch Academy etj.<br><br>*Referenca:*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019*<br>*1.1.a Raporti Vjetor - DI - v.a. 2018 - 2019*<br>*1.1.c Raporti vjetor - DI - v.a. 2020 - 2021*<br>*1.1.d Raporti Sem. I - DI - v.a. 2021 - 2022* |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Nga mbikqyrja e faqes WEB të institucionit, Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me kompani private që operojnë në fushën përkatëse të programit të studimit. Po ashtu institucioni ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me një kompani të madhe që operon në vendin tonë. Nga ana tjetër bashkëpunimet me institucione homologe brënda ose jashtë vendit në dokumentacionin e paraqitur janë të shumta. Megjithate duhet thënë se nga vizita në institucion GVJ u njoh me politikat e tij për bashkëpunime me aktorë homologe brenda dhe jashtë vendit. Po ashtu konstatua se institucioni deklaron një sërë marreveshjesh me institucione homologe brenga dhe jashte vendit.<br><br>*Referenca:*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK*<br>*R.3 Marrëveshje bashkëpunimi Albtelecom sh.a. - Nr. Prot. 83, dt. 02.03.2020*<br>*1.7.a Raporti analitik marreveshje praktika - 2021*<br>*1.7.b Raport analitik marrëveshjet praktika mësimore Departamenti i Inxhinierive - v.a. 2021 – 2022*<br>*https://albanianuniversity.edu.al/sq/marreveshje-bashkepunimi-me-universitete/* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan | GVJ konstaton se Institucioni ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashakëpunimi me qëllim realizimin e praktikës mësimore, i cili është detyrim që studentët duhet të përmbushin në semestrin e dyte të vitit |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | të trete të studimeve. Disa nga këto kompani janë: A. E. Distribution, Computer Copy Center sh.p.k, Xpert Systems sh.p.k, Engineering Group sh.p.k, Information Business Systems, Real Vizualz etj.<br><br>*Referenca:*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK*<br>*1.7.a Raporti analitik marreveshje praktika - 2021*<br>*1.7.b Raport analitik marrëveshjet praktika mësimore Departamenti i Inxhinierive - v.a. 2021 – 2022* |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Institucioni ka krijuar disa grupe në nivel Njësie Kryesore për të siguruar mbikëqyrjen e programit mësimor dhe ka përgatitur një raport analitik mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit për zbatimin e programit të studimit.<br><br>*Referenca:*<br>*1.7.a Raporti analitik marreveshje praktika - 2021*<br>*1.7.b Raport analitik marrëveshjet praktika mësimore Departamenti i Inxhinierive - v.a. 2021 – 2022* |
| **Konkluzione** | *Institucioni ka hartuar programin e studimit "Inxhinieri Kompjuterike" duke u bazuar në studimin e tregut si dhe në bashkëpunimin midis struktura të vet Institucionit. Po ashtu Institucioni ka ngritur një sere grupesh për mbikqyrjen dhe mbarevajtjen e programit të studimit. Nga ana tjeter Institucioni ka nënshkruar një sere marrëveshjesh me aktore të biznesit për realizimin e praktikave mësimore si dhe me institucione homologe. Si përfundim GVJ mendon se Institucioni i përmbush plotësisht kriteret ligjore.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al



## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | GVJ bazuar në dokumentacion kontstaton se program i studimit bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike", përbëhet nga tre vite akademike, e cila rezulton në 6 semestra në total, e vleresuar me 180 kredite ECTS. Ky program studimi ka në kurrikulen e tij lënde semestrale, por edhe lënde në module. Ndarja e lëndëve përbërëse në kurrikul, sipas kategorive A-E është si më poshtë vijon:<br><br>**-Lëndë bazë -** Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A) plotësojnë *33 ETCS ose 18.33%* të programit të studimit.<br>**-Lënde karakterizuese** - Përgatitje për disiplinën shkencore (B) plotësojnë *95 ETCS ose 52.78%* të programit të studimit.<br>**-Lëndë ndërdisiplinore/integruese** - Nëndisiplina, Profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) plotësojnë *24 ETCS ose 13.33%* të programit të studimit.<br>**-Lëndë plotësuese** - gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D) plotësojnë *22 ECTS ose 12.22%* të programit të studimit.<br>**-Detyrime përmbyllëse** (E) plotësojnë *6 ETCS ose 3.33%* të programit të studimit.<br><br>*Referenca:*<br>*2.1.a Kurrikula BSc. IK – 04.2019*<br>*2.1.b Plani mesimor BSc. IK - 04.2019*<br>*R.4 Syllabuse BSc. IK – v.a. 2022 – 2023.pdf*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK.pdf* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi | Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" ka në fokus të tij përgatitjen e specialistëve të aftë për të punuar e zgjidhur probleme në fushën inxhinierike të informatikes & teknologjive të komunikimit. Produkt i kësaj është një kurrikul ku janë prezente lëndë të cilat ofrojnë formim bazik dhe në vitet më të larta të studimit janë prezente lëndë me formim karakterizues e me profesional.<br>Nga dokumentacioni i dorëzuar, por edhe nga intervistat e realizuara konnstatojme se duhet bërë një shpërndarje më e drejte e lëndëve prezente në kurrikul përgjate 3 viteve të studimit për ti ofruar studentëve preazantim e shpjegim më të qartë të koncepteve HW, |

| | |
|---|---|
| dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | sisteme operimi, SW duke përfshirë këtu lënde programimi. Lëndët e rrjeteve kompjuterike duhen integruar në mënyre më të drejte në kurrikul. Duhen ristrukturuar dhe/ose evituar sipas rastit lëndët me karakter elektronik për ti qëndruar besnik fokusit të inxhinierisë kompjuterike që ka ky program studimi.<br><br><br>*Referenca:*<br>*R.4 Syllabuse BSc. IK – v.a. 2022 – 2023.pdf*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK.pdf*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019.pdf* |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Nga dokumentacioni i dorëzuar vërejme se cdo lënde në kurrikul është e vlerësuar me një numër të caktuar kreditesh ECTS. Për secilën lënde në kurrikul janë prezente elementet e leksioneve, seminareve dhe oreve të laboratorit. Sipas planit mësimor për këtë program studimi lendet prezente janë të ndara në gruplende sipas kategorive A, B, C, D, E në perputhje me kuadrin ligjor. Ajo që vërejme është se duhet bërë një shpërndarje më e drejte e lëndëve prezente në kurrikul përgjate 3 viteve të studimit për ti ofruar studenteve preazantim e shpjegim më të qartë të koncepteve HW, sisteme operimi, SW duke përfshire këtu lëndë programimi. Lëndët e rrjeteve kompjuterike duhen integruar në mënyre më të drejte në kurrikul. Duhen ristrukturuar dhe/ose evituar sipas rastit lëndët me karakter elektronik për ti qëndruar besnik fokusit të inxhinirise kompjuterike që ka ky program studimi.<br><br>*Referenca:*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019.pdf*<br>*R.4 Syllabuse BSc. IK – v.a. 2022 – 2023.pdf*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK.pdf* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Në kurrikulën e programit të studimit bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike", lënda "Praktike Profesionale" ofrohet në vitin e trete, në semestrin e dyte të studimeve e vlerësuar me 4 (kater) kredite ECTS. Sipas rregullores studenti e kryen praktiken profesionale në një nga institucionet me të cilat Albanian University ka marreveshje bashkepunimi dhe vleresohet me noten përkatëse pas prezantimit të një relacioni në departament.<br>Detyrimet përmbyllëse vleresohen me 6 (gjashte) kredite ECTS. Studenti i nënshtrohet një provimi formimi ose realizon një teze (punim diplome).<br><br><br>*Referenca:*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019.pdf* |

| | |
|---|---|
| | *2.2 Miratim udhëheqës praktika mësimore programet e studimit BSc. - v.a. 2021 – 2022* |
| **Kriteri 5.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Albanian University nuk është një institucion i arsimit të larte me status të vecante. |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Bazuar në raportin e hartuar nga Institucioni si edhe dokumentacioni konstatojme se Departamenti i Inxhinierive ofron 5 programe studimi bachelor ku tre prej tyre janë me karakter inxhinierik, 3 programe studimi në ciklin e dyte; 2 programe master i Shkencave dhe 1 program master Profesional. Programet bachelor me karakter inxhinierik ku bën pjese edhe programi "Inxhinieri Kompjuterike" kanë ngjashmëri në kurrikul kryesisht në lëndët baze të zhvilluara, por edhe në disa lëndë formuese e specifike.<br><br>*Referenca:*<br>*1.1.e Raporti vjetor Departamenti i Inxhinierive – v.a. 2021 – 2022* |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Në perputhje me Udhezimin e MAS Nr. 31. date 15.11.2022 mbi kodifikimin e programeve të studimit, institucioni është në përgatitjen e kodifikimit dhe dorëzimin brënda kohës së përcaktuar ligjore. |
| **Kriteri 8.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" nuk ofrohet si program i përbashkët studimi në bashkëpunim me ndonjë institucion tjetër. |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se duhet bëre një shpërndarje më e drejte e lëndëve prezente në kurrikul përgjate 3 viteve të studimit për ti ofruar studenteve preazantim e shpjegim më të qartë të koncepteve HW, sisteme operimi, SW duke përfshire këtu lënde programimi.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Lëndët e rrjeteve kompjuterike duhen integruar në mënyre më të drejtë në kurrikul.*<br>*Duhen ristrukturuar dhe/ose evituar sipas rastit lëndët me karakter elektronik për ti qëndruar besnik fokusit të inxhinirise kompjuterike që ka ky program studimi.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike: si njësi kryesore është e përbërë nga këto njësi bazë:<br>• Departamenti i Shkencave Ekonomike<br>• Departamenti i Inxhinierive<br>• Departamenti i Art Dizajn<br><br>Fakulteti i Shkencave të Aplikuar dhe Ekonomike për vitin akademik **2022-2023** është i përbër nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti **18 PAE** dhe **18 PAK** Personel Akademik me Kontratë, dhe 1 Personel Ndihmës akamdemik.<br>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin, strukturën akademike dhe akreditimin. Nga ana tjetër përmbush pjesërisht kriteret e stafeve akademike pasi vërehet mungese e stafeve të brëndshme dhe të kualifikuar për fushat që mbulojnë bazuar në ngarkesën e tyre mësimore. Përsa i përket cilësisë së stafit të angazhuar në njësinë bazë për këtë program studimi, për 3 vitet e fundit është si më poshtë vijon: |

**Cilësia e stafit të Departamenti i Inxhinierive.**

| Titulli/Grada | 2020-2021 | | 2021-2022 | | 2022-2023 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof.Dr | - | 2 | - | 2 | - | 1 |
| Prof.Asoc. | - | 5 | 1 | 5 | 1 | 4 |
| Dr. | 7 | 7 | 7 | 11 | 7 | 12 |
| MSc. | 8 | 3 | 9 | 1 | 10 | 1 |
| **Gjithsej** | **15** | **17** | **17** | **19** | **18** | **18** |

| | |
|---|---|
| | *Referenca:*<br>*R.4 Syllabuse BSc. IK – v.a. 2022 – 2023*<br>*1.1.a Raporti Vjetor - DI - v.a. 2018 - 2019*<br>*1.1.c Raporti vjetor - DI - v.a. 2020 - 2021*<br>*1.1.d Raporti Sem. I - DI - v.a. 2021 - 2022*<br>*4.2 CV stafi akademik BSc. IK - v.a 2022 - 2023* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi duke angazhuar personel ndihmës administrativ, por nga ana tjeter, në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, vërehet mungesa e personelit ndihmës akademik në zhvillimin e laboratorēve apo praktikave mesimore edhe pse këta të fundit janë të parashikuar në rregulloren e institucionit. Megjithate nga vizita e GVJ në institucion u njoh me stafin ndihmës akademik i cili është i angazhuar në mirëmbajtjen e laboratoreve dhe instruktimin e përdorimit të pajisjeve nga studentet.<br><br>*Referenca:*<br>*R.4 Syllabuse BSc. IK – v.a. 2022 – 2023*<br>*1.1.a Raporti Vjetor - DI - v.a. 2018 - 2019*<br>*1.1.c Raporti vjetor - DI - v.a. 2020 - 2021*<br>*1.1.d Raporti Sem. I - DI - v.a. 2021 - 2022*<br>*1.3 Rregullore Albanian University*<br>*4.2 CV stafi akademik BSc. IK - v.a 2022 - 2023* |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit ka caktuar një staf administrativ në rolin e koordinatorit të programit të studimit. Po ashtu duke respektuar legjizlacionin në fuqi njësia kryesore ka bëre edhe zëvendesimet përkatëse kur koordinatori i mëparshëm është larguar.<br>Po ashtu njësia kryesore ka caktuar edhe koordinatorin e grup-lëndëve.<br><br>*Referenca:*<br>*2.4.a Koordinatorët e gruplëndëve DI*<br>*2.4.b Koordinatorët e programeve të studimit DI* |
| **Konkluzione** | *GVJ sugjeron se institucioni duhet të bëje më shumë për të kualifikuar dhe angazhuar staf me tituj akademike por po ashtu edhe staf i cili ka njohuri të thella shkenvore dhe akademike për fushat të cilët ata mbulojne dhe sidomos në disa prej lendeve të teknologjise së informacionit. GVJ mendon se Njësia Bazë përgjegjëse për programin e studimit i përmbush kryesisht kerkesat ligjore dhe standartet e cilësisë.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" ofrohet nga Departamenti i Inxhinierive pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Njësia kryesore, si edhe Njësia baze që e ofron këtë program studimi kanë rregulloret e tyre përkatëse, të cilat rregullojnë veprimtarinë e tyre akademike dhe organizative për të gjithe programet e studimit që këto njësi mbulojnë. Përpos kësaj programi i studimit ka edhe rregulloren përkatese. Nga takimet e realizuara në Institucion,<br>*GVJ konstaton* se Departamenti i Inxhinierive, i cili mbulon këtë program studimi disponon të gjitha informacionet e nevojshme për programin e studimit në elementët e tij akademik si kurrikula, plani mësimor, syllabuse etj, dhe strukturen e tij përbërëse. Përpos kësaj Departamenti i Inxhinerive realizon edhe raportin vjetor për cdo vit akademik ku analizohen tregues cilesore dhe sasiore për programin e studimit, ngarkesën mësimore të stafit akademik, aplikime në projekte, marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programeve të studimit që mbulon njësia etj.<br><br>*Referenca:*<br>*1.6 Rregullore FSHAE - 20.04.2022*<br>*2.3 Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019.pdf*<br>*1.1.a Raporti Vjetor - DI - v.a. 2018 - 2019*<br>*1.1.c Raporti vjetor - DI - v.a. 2020 - 2021*<br>*1.1.d Raporti Sem. I - DI - v.a. 2021 - 2022*<br>*Takime ne Institucion* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" jepet i gjithë informacioni për ndarjen e lëndëve në semestra, kategorine në të cilën ato bëjne pjesë dhe ngarkesen që zënë me ore brënda dhe jashte auditorit.<br><br>*Referenca:*<br>*2.1.b Plani mesimor BSc. IK - 04.2019* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe shqyrtimit të raportit, në rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve të Albanian University, jepen informacionet e nevojshme për pranimin e studenteve në ciklin e pare, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve.<br><br>*Referenca:*<br>*2.5 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve - VS 25 - dt. 25.06.2020.* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | GVJ konstaton se syllabuset e programit bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" kane një format të përshtatur sipas të gjitha elementeve përkatëse sipas VKM Nr.41, date 24.01.2018 ku jepet informacion për ndarjen në orë leksioni, seminare dhe laboratore. Përpos kësaj jepen temat për cdo lëndë, mënyra e vleresimit si edhe literatura mbështetëse.<br><br>*Referenca:*<br>*R.4 Syllabuse BSc. IK – v.a. 2022 – 2023* |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | Sipas dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstaton se janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësim dhe përditësim të kurrikulës për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Informatike".<br>Në Mars 2019, Departamenti i Inxhinierive rishikoi programet e studimit *Bachelor* në një nivel ndryshimesh deri në 20% konform legjislacionit në fuqi. Në cdo fillim viti akademik syllabuset mund ti nënshtrohen ndryshimeve deri në 20% bazuar në eksperiencën e pedagogut përkatës.<br><br>*Referenca:*<br>*2.6 Procedura e rishikimit të kurrikulave programet e studimit Bachelor – 04.2019*<br>*2.7.a Rishikime syllabuse - v.a. 2018 - 2019*<br>*2.7.b Rishikime syllabuse - v.a. 2019 - 2020*<br>*2.7.c Rishikime syllabuse - v.a. 2020 - 2021*<br>*2.7.d Rishikime syllabuse - v.a. 2021 - 2022*<br>*2.7.e Rishikime syllabuse - v.a. 2022 – 2023* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se programi i studimit bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" përmban në planin mësimor, kurrikul dhe syllabuse të gjithë elementët e nevojshëm informues mbi llojin e lëndës, ndarjes në leksione, seminare, ore laboratori, mënyren e vleresimit sipas legjislacionit në fuqi. Pavarësisht ndryshimeve të vazhdueshme në kurrikulen e programit të studimit GVJ konludon se duhen bërë ndërhyrje të mëtejshme në strukturimin e lëndëve për të krijuar një prezantim gradual të koncepteve.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Programi i studimit studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" është i organizuar në tre vite akamedike me gjithsej 180 kredite. Në secilin vit akademik programi ka gjithsej 60 kredite.<br>Emërtesat, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë konstruktimin e njohurive, aftësive duke kontribuar në punësimin e studenteve. Para se të miratohen, kurrikulat janë konsultuar si me pedagoge, ashtu edhe me aktorët e tregut të punës. Kur njësia bazë gjykon të nevojshme të bëhet një ndryshim në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit nën vleresimin për akreditim, e ndërmerr atë në përputhje me kriteret ligjore të parashikuara dhe aktet rregullatore të institucionit.<br>Shpërndarja e lëndeve ndjek logjiken e avancimit nga lëndët baze të formimit të përgjithshëm, në lëndë me karakter praktik.<br><br>Referenca:<br>R.4 Syllabuse BSc. IK – v.a. 2022 – 2023<br>1.3 Rregullore Albanian University<br>2.1.a Kurrikula BSc. IK – 04.2019<br>2.1.b Plani mesimor BSc. IK - 04.2019<br>2.3 Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021 |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. | Gjatë një viti akademik, organizimi i veprimtarise mësimore shtrihet në 6 (gjashte) semestra me kohëzgjatje normale 14 jave. Studimet në këtë program janë së paku me 180 ECTS. Ngarkesa vjetore është 60 ECTS, edhe pse jo e ndare në mënyre të barabarte 30 ECTS, për cdo semester, konform legjislacionit në fuqi. Megjithate, kjo ndarje, mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit. Gjithashtu, kontrolli i vazhdueshëm, detyrat praktike gjatë seminarit, rrisin mundësine për të kuptuar nëse studentët po i arrijnë objektivat mësimore.<br>Programi i studimit është i organizuar në mënyre të tille që studenti të marre formimin dhe kompetencat e duhura, kryesisht teorike por nga ana tjeter edhe praktike, për arritjen e objektivave profesionale me qëllim punësimin e studentëve. |

| | |
|---|---|
| | *Referenca:*<br>*2.1.a Kurrikula BSc. IK – 04.2019*<br>*2.1.b Plani mesimor BSc. IK - 04.2019*<br>*2.3 Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021*<br>*2.1.c Miratim ore per ECTS - programe DI - VSA. 13, dt. 07.04.2021* |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Lëndët janë të organizuara në aktivitete formuese Leksion / Seminar / Ushtrime / Laboratore / Detyra – Projekte / Praktika. Në seicilën prej tyre ka aktivitete formuese teorike dhe praktike. Në këtë kurrikul shpërndarja e krediteve në aktivitetet formuese është si më poshtë:<br><br>• **Leksione 100 ECTS**<br>• **Seminre 4 ECTS**<br>• **Ushtrime 41 ECTS**<br>• **Laboratore 15.5 ECTS**<br>• **Detyra/Projekte/diplome 15.5 ECTS**<br>• **Praktike 4 ECTS**<br><br>Sa me sipër 55.6% të krediteve totale i janë alokuar përgatitjes teorike, pra leksioneve dhe 44.4% e krediteve jane të lidhura me përgatitjen praktike përfshire këtu edhe punimi i diplomes.<br>Nëse do t'i referoheshim orëve të planifikuar në auditor për këto aktivitete formuese do të kishim si më poshtë:<br><br>• **Leksione 749 Ore ne auditor**<br>• **Seminare 32 Ore ne auditor**<br>• **Ushtrime 619 Ore ne auditor**<br>• **Laboratore 370 Ore ne auditor**<br>• **Detyra/Projekte/diplome 31 Ore ne auditor**<br>• **Praktike 80 Ore ne auditor.**<br><br>Orët në auditor, gjithsej 1881, përbëjnë 42.1% të fondit total të orëve të këtij programi studimi. Orët jashtë auditorit (studim individual) përbëjnë 57.9% të ngarkesës totale.<br>Raporti teori praktike, referuar orëve në auditor do të ishte 39.8% e orëve në auditor i përkasin përgatitjes teorike (leksioneve) dhe 60.2% e orëve në auditor krediteve janë të lidhura me përgatitjen praktike përfshire ketu edhe punimi i diplomës. Pra sasia e orëve në auditor për përgatitje praktike të studentit janë disi më të mëdha se orët e alokuar për përgatitje teorike. Ky program studimi e vë theksin më shumë në përgatitjen praktike të studentit. Gjykoj se në këtë disproporcion ndikon, nga njëra anë, raporti 1 ECTS/orë në auditor i përdorur për këtë program studimi dhe nga ana tjetër edhe ndarja e kriditeve për cdo lëndë ku përgatitjes praktike i alokohen më shumë orë në auditor: |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | • 1 ECTS leksion = 7.5 ore ne auditor<br>• 1 ECTS Seminare = 8 ore ne auditor<br>• 1 ECTS Ushtrime = 15 ore ne auditor<br>• 1 ECTS laborator = 23 ore ne auditor<br>• 1 ECTS detyre/projekt = 2 ore ne auditor<br>• 1 ECTS praktike = 20 ore ne auditor<br><br>*GVJ është i mendimit se struktura e programit të studimit është në përputhje me profilin e këtij programi por mendojme se raportet midis anës teorike dhe praktike duhen rishikuar. Raporti teori-praktike i lëndëve ka nevoje për rishikim që do të forconte mundësin e aftësimit si teorik ashtu edhe praktik të studenteve.*<br><br>*Referenca:*<br>*2.1.a Kurrikula BSc. IK – 04.2019*<br>*2.1.b Plani mesimor BSc. IK - 04.2019*<br>*2.3 Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021*<br>*2.1.c Miratim ore per ECTS - programe DI - VSA. 13, dt. 07.04.2021* |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Disiplinat mësimore dhe veprimtarite e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A – ja deri te E – ja. Në kategorine A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë, në kategorine B disiplina të formimit karakterizues të programit, në kategorine C disiplina të formimit profesional, në kategorine D veprimtari formuese për njohje të gjuhëve të huaja, aftësime kompjuterike dhe praktika profesionale. Në kategorine E janë Detyrime përmbyllese, që lidhen me përgatitjen e projektit të diplomës ose me provimin përfundimtar.<br>Përfundimi me sukses i programit të studimit e çon studentin në tregun e punës ose i jep mundësi atij për njohjen/transferimin e krediteve të grumbulluara në institucione homologe.<br><br>*Referenca:*<br>*2.1.a Kurrikula BSc. IK – 04.2019*<br>*2.1.b Plani mesimor BSc. IK - 04.2019* |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë | GVJ vëren se bazuar në rregulloren e departamentit si dhe në atë të institucionit "Grupi i Sigurimit të Cilësise" në bashkepunim me personelin akademik, në këtë rast edhe me koordinatorët e gruplëndëve, propozojne dhe rishikojne të gjitha ndryshime e kurrikulave në periudha një vjecare. Nga ana tjeter kjo praktike vërehet se ka ndodhur në realitet me programin e studimit në vitet e fundit bazuar edhe në dokumentacionin shkresor që institucioni ka ofruar. |

<table>
<tr><td>literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</td><td colspan="4"><br>Referenca:<br>Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021<br>2.1.b Plani mesimor BSc. IK - 04.2019<br>2.6 Procedura e rishikimit të kurrikulave programet e studimit Bachelor – 04.2019<br>2.7.a Rishikime syllabuse - v.a. 2018 - 2019<br>2.7.b Rishikime syllabuse - v.a. 2019 - 2020<br>2.7.c Rishikime syllabuse - v.a. 2020 - 2021<br>2.7.d Rishikime syllabuse - v.a. 2021 - 2022<br>2.7.e Rishikime syllabuse - v.a. 2022 – 2023</td></tr>
<tr><td>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</td><td colspan="4">GVJ konstaton në bazë të dokumentave se sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kopetencat që përftojne studentet nëpërmjet tij, janë plotesisht në përputhje me synimin e vetë programit të studimit.<br><br>Referenca:<br>2.1.a Kurrikula BSc. IK – 04.2019<br>2.1.b Plani mesimor BSc. IK - 04.2019</td></tr>
<tr><td>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</td><td colspan="4">GVJ konstaton në bazë të dokumentave se sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kopetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundeson atyre vazhdimin në ciklin e dytë të studimeve universitare. Por nga ana tjeter ky program studimi ju jep studentëve edhe aftësitë praktike për tu futur në tregun e punës.<br><br>Referenca:<br>2.1.a Kurrikula BSc. IK – 04.2019<br>2.1.b Plani mesimor BSc. IK - 04.2019</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">Grupi i ekspertëve të jashtem sugjeron se për të forcuar përgatitjen teorike, në mënyre që studenti të marrë njohuri të thelluara teorike për vijimin e studimeve në ciklet e tjera, është mirë të shtohet fondi i orëve në auditor për leksionet, duke respektuar gjithmonë standardin që orët në auditor të mos e kalojne gjysmën e fondit total të orëve. Lëndët inxhinjerike kanë nevoje për shpjegime dhe interpretime të koncepteve dhe njohurive shkencore nga ana e pedagogut.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td>X</td><td></td></tr>
</table>

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Nga dokumentacioni i dorëzuar GVJ konstaton se Departamenti i Inxhinierive ka zhvilluar studime të detajuara të tregut që mund të reflektojnë përmirësim të kurrikulave të programeve të studimit të ofruara në përputhje me kërkesat e tregut, si dhe në hapjen e programeve të reja në përputhje me mundësite e punësimit të ofruara në nivel kombëtar e ndërkombëtar.<br><br>*Referenca:*<br>*2.9.a Raport mbi studimin e tregut - DI - Korrik 2019*<br>*2.9.b Raport mbi studimin e tregut - DI - Dhjetor 2021* |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | Institucioni nxit dhe mbështet studentët e përfshire në strukturat vendimarrëse të tij në mbledhjet e Departamentit, në mbledhjet e Senatit Akademik, përfaqesuesit e Këshillit Studentor dhe cdo student apo të diplomuar që të bëhen pjese e diskutimeve dhe konsultimeve për përmirësimin e programeve të studimit.<br><br>*GVJ konstaton se përfaqesuesit* e Këshillit studentor kanë të drejtë të japin mendimin e tyre në përmirësimin e kurrikulave. Mendimi i studenteve të diplomuar në lidhje me përmiresimin e kurrikulave dhe programit të studimit duhet analizuar nëpërmjet pytesorëve që u jepen atyre për të vleresuar mendimin e tyre mbi eksperiencën akademike. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | GVJ konstaton se njësia përgjegjëse për përmiresimin e programit të studimit dhe kurrikules se tij ka angazhuar në grupin e ekspertëve anëtar të grupit të punës përfaqsues nga biznesi të cilët lidhin eksperiencen e tyre të punës me programin e studimit.<br><br>*Referenca:*<br>*2.10 Ngritja e GE për rishikimin e kurrikulave BSc. – 04.2019* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se njësia përgjegjëse për programin e studimit ka bërë përpjekje në përmirësimin e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" duke përfshire këtu studente, studente të* |

| | |
|---|---|
| | *diplomuar dhe duke bëre pjese të grupit të punes për përmiresimin e kurrikulave anetare eksperte të jashtem të biznesit. GVJ konludon se mendimi i studenteve për përmiresimin e kurrikules dhe elementeve të tjere përbërës mund të meret më mire në konsiderate duke integruar pyetje specifike në pyetesorin që studentët e diplomuar plotesojnë.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Metodologjitë e mësimdhënies së përdorura në programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" përshkruhen në Rregulloren Themelore, Rregulloren e Ciklit të parë të studimeve, Rregulloren e Programit të Studimit.<br>Bazuar në syllabuset e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike", si edhe intervistave të realizuara nga GVJ me stafin e angazhuar në mësimdhënie konstatojme se format e mësimdhënies në transmetimin e dijeve janë: leksionet, seminaret, pune laboratori. Në vlerësimin e studenteve, përpos provimeve zene peshe detyrat e kursit, projektet e ndryshme sipas specifikes së lëndës.<br>1. Ngarkesa në auditor e studentëve **[RVB, Tabela 13]** është e organizuar në leksione (758 orë),<br>2. seminare (32 orë),<br>3. ushtrime/laboratorë (619 orë),<br>4. forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor (19 orë),<br>5. praktikë profesionale (80 orë) dhe udhëheqje teze diplome/konsultime për provimin përfundimtar të formimit (12 orë), gjithsej 1890 orë. |

| | |
|---|---|
| | *Referenca:*<br>*R.4 Syllabuse BSc. IK – v.a. 2022 – 2023* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | GVJ konstaton nga intervistat me stafin e angazhuar në mësimdhënie se ata integrojnë forma të ndryshme të mësimdhenies duke shfryëzuar edhe infrastrukturen në dispozicion për t'ju përgjigjur nevojave të studenteve duke filluar nga shpjegimi i koncepteve teorike, integrimi i ushtrimeve në seminar me orët në laborator për realizimin e projekteve sipas specifikave të lëndeve të ndryshme.<br><br>*Referenca:*<br>*R.4 Syllabuse BSc. IK – v.a. 2022 – 2023* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | Bazuar në dokumentacion si edhe takimet në Institucion, GVJ konstaton se, Njësia e sigurise së brendshme të cilësisë (NJSBC) realizon trajnime në nivel pedagogjik përgjate vitit akademik me referues të brendshëm, por edhe online me referues të huaj në kuader të ngritjes se kapacitetit mësimdhënës të stafit akademik në Institucion.<br><br>*Referenca:*<br>*3.1.a Axhenda e trajnimeve te stafit akademik - v.a. 2019 – 2020*<br>*3.1.b Axhenda e trajnimeve te stafit akademik - v.a. 2021 – 2022*<br>*Takime staf akademik & administrativ ne Institucion* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë<br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, si edhe në intervistat me stafin e angazhuar në mësimdhënie konstaton se personeli akademik i angazhuar pranë departamentit të Inxhinierive ofron një mësimdhënie cilësore, në të cilat ndërthurin njohuritë teorike të dhëna drejtepërdrejtë gjatë leksioneve dhe seminareve me ato praktike, përmes simulimeve dhe eksperimentimeve në laboratorë.<br><br>Krahas aktiviteteve të tyre, stafi akademik angazhohet në nxitjen e studentëve për të mësuar përmes përdorimit të platformave online si Microsoft Teams, ku u ofrohen materiale të ndryshme mësimore dhe teste vetëvlerësuese.<br><br>Në çdo lëndë, orët e mësimit përfshijnë seminare, ushtrime dhe laboratorë, të cilat zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me studentët, duke i përgatitur ata për nevojat konkrete të tregut të punës. Këto aktivitete nxisin autonominë e studentit.<br><br>Megjithatë, konsiderojmë të domosdoshme rekrutimin e stafit të ri për të realizuar një shpërndarje më të mirë të lëndëve të ndryshme, në mënyrë që të rritet cilësia e mësimdhënies dhe kualifikimi i stafit.<br><br>*Referena:*<br>*1.5 Përshkrimi i Laboratoreve të Departamentit të Inxhinierive*<br>*3.2 Klasat Microsoft Teams - Departamenti i Inxhinierive* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. | Departamenti i Inxhinierive të kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies.<br>GVJ konstaton se njësia përgjegjëse e përfshin studentin në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të mësimdhënies nëpërmjet organizimit të anketave përmes pyetësorëve, të cilat realizohen për cdo lëndë, dy herë në vitë për cdo semester përkatësisht. Përpos përgjigjes së pyetjeve studentët aty japin edhe sygjerimet e tyre në koment dhe mendim të lirë.<br><br>*Referenca:*<br>*3.3 Shembull pyetësori në MF - BSc. IK - Viti I - Sem. I*<br>*6.9.f Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. I - v.a. 2021 - 2022*<br>*6.9.g Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. II - v.a. 2021 - 2022* |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | GVJ konstaton se Albanian University ka Njësinë e Sigurimit të Brendshem të Cilesise si edhe Zyren e Zhvillimit të Kurrikulave që meren kryesisht me organizimin e materialeve dhe aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie.<br>Gjatë pandemisë Covid-19 dhe më pas, institucioni ka organizuar trajnime të ndryshme për përdorimin e mjeteve informatike në funksion të mësimdhënies dhe ka përgatitur udhëzues specifikë për pedagogët dhe studentët.<br><br>*Referena:*<br>*1.3 Rregullore Albanian University*<br>*3.4.a Manual per realizimin e mesimit online 2020 - 2021*<br>*3.4.b Manuali i provimeve online 2020 - 2021*<br>*3.4.c Udhezues video per perdorimin e platformes Microsoft Teams.* |
| **Konkluzione** | *GVJ është i mendimit se stafi akademik integron forma të ndryshme të mësimdhënies në përgjigje të nevojave të ndryshme të studenteve, si edhe shfrytëzon platformat online për të rritur cilësine e mësimdhënies e për të bërë atë më bashkëkohore. GVJ gjithashtu konstaton se njësia përgjegjëse duhet të angazhohet në rekrutimin e stafit të ri në mënyre që të ulet ngarkesa e stafit aktual të angazhuar kryesisht në lidhje me tipologjite e lëndeve sipas kuadrit ligjor në fuqi (3 lënde të ndryshme në semester). Vetem kështu mund të rritet performanca e mësimdhënies.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Kriteret e vleresimit të studenteve janë të paraqitura në rregulloren e institucionit. Megjithate në syllabusin e lëndeve është dhënë dhe metoda e vlerësimit të studentit. Metoda e vleresimit është publike dhe studenti është i njohur me të.<br>Format e kontrollit të dijeve në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit janë: provimi me shkrim, me gojë, me detyra kursi/projekte, i kombinuar me seminare workshope, frekuentime e studime laboratorike. Në rregulloren mësimore dhe në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijes.<br><br>*Referenca:*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019*<br>*1.3 Rregullore Albanian University* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Nga vizita në institucion rezultoi se në fillimi të cdo viti akademik student informohet në lidhje me metodologjine e testimit dhe vlerësimin e njohurive dhe dijeve. Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm notave të:<br><br>• Provimit përfundimtar 60 pike (60% të notës përfundimtare),<br>• Provimi i ndërmjetëm 20 pike (20% të notës përfundimtare),<br>• Pjesemarrja aktive në ushtrime, seminare, pune laboratorike, detyra/projekte kursi 20 pike (20% të notës përfundimtare)<br><br>*Referenca:*<br>*R.4 Syllabuse BSc. IK – v.a. 2022 – 2023* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Studentët njihen me format e vlerësimit që në orët e para të mësimit. Kjo mundësohet nga ana e pedagogut të lëndës, gjate njohjes së studentit me përmbajtjen e programit të lëndës. Dija e studentit kontrollohet në cdo rast nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm të pedagogut me studentin në formën e bashkëbisedimit, nëpërmjet zhvillimit të testimeve ose seancave të kontrollit të dijes. |

| | |
|---|---|
| | *Referenca:*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019*<br>*1.3 Rregullore Albanian University* |
| **Kriteri 4.** Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Personeli akademik dhe njësia bazë e institucionit shqyrton dhe në raste të caktuara përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyre periodike, duke përfshire studentet në këtë proces nëpërmjet anketimeve që institucioni kryhen me pjesmarrjen e studentëve.<br>Nga ana tjeter GVJ, gjatë vizitës në institucion, mbas shqyrtimit në mënyre rastësore të disa procesverbaleve të vlerësimeve përfundimtare vërejti se 100% e studentëve ishte vlerësuar me notë kaluese që në sezonin e rregullt të lëndës përkatëse. Megjithëse nuk u konstatuan prova parregullsie, në gjykimin e GVJ ngelet shume shqetësues fakti që të gjithë studentet të jenë vlerësuar me note kaluese që në sezonin e rregullt.<br><br>*Referenca:*<br>*Shembull pyetësori në MF - BSc. IK - Viti I - Sem. I*<br>*6.9.f Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. I - v.a. 2021 - 2022*<br>*6.9.g Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. II - v.a. 2021 - 2022* |
| **Kriteri 5.** Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Departamenti i Inxhinierive vendos në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve infrastrukturën e nevojshme teknologjike për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies me qëllim realizimin e objektivave formues të studentëve në përputhje me nevojat e tregut të punës.<br>Institucioni ka përdorur metoda të shumëllojshme inovative dhe fleksibile gjatë periudhës së pandemise që preku vendin tone duke përdorur instrumenta effektive për përmbushjen e objektivave formuese. Nga ana tjeter institucioni ka përdorur dhe ka subvencionuar përdorimin e intrumentave si Microsoft Teams.<br>Cdo fillim viti akademik institucioni, organizon trajnime për stafin akademik, kryesisht atë të ri, të rekrutuar në kuader të mësimdhënies.<br><br>*Referenca:*<br>*3.1.a Axhenda e trajnimeve te stafit akademik - v.a. 2019 – 2020*<br>*3.1.b Axhenda e trajnimeve te stafit akademik - v.a. 2021 – 2022*<br>*3.2 Klasat Microsoft Teams - Departamenti i Inxhinierive* |
| **Konkluzione** | *GVJ është i mendimit se institucioni harton rregullore dhe procedura të posacme të testimit e vleresimit t njohurive, dijeve dhe aftesive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre duke përmbushur plotesisht këtë kriter.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | GVJ konstaton se kontrolli i dijeve për cdo lënde në programin e studimit është i vazhdueshem dhe përfshin disa forma. Vlerësimi i dijeve realizohet përgjatë gjithë kohëzgjatjes së lëndës/modulit. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementeve të mëposhtëm:<br>• Provimi përfundimtar 60 pike (60%).<br>• Provimi i ndërmjetem 20 pike (20%).<br>• Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive në seminarë, punë laboratorike<br>• detyra/projekte kursi 20 pike (20%).<br><br>*Referenca:*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019*<br>*R.4 Syllabuse BSc. IK – v.a. 2022 – 2023* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Sistemi elektronik i përdorur në "Albanian University" është Pitagora. Këtu studentët njihen me kurrikulën, lëndët dhe notat për secilën lënde të kurrikulës. Nderkohe proces-verbalet me notat perfundimtare per cdo lende plotesohen plotesohen me shkrim dore nga stafi akademik, të cilat shërbejne edhe si dokument zyrtar.<br>GVJ konstaton se një transparenca do të rritej nëse proces-verbalet do të gjeneroheshin elektronikisht duke shmangur kështu forma të ndërhyrjes dhe korigjimit të proces-verbaleve nga palë të treta. |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar i studentit bëhet sipas syllabusit për secilën lëndë. Përgjithësisht në format e vlerësimit përfundimtar përfshihen testimi me shkrim përkatesisht testim i ndërmjetëm, testim përfundimtar detyra kursi/projekt, pjesëmarje aktive në mësim. Provimi përfundimtar zë 60% të notës përfundimtare.<br><br>*Referenca:*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019, Neni 24, fq.17-18* |

| | |
|---|---|
| | *R.4 Syllabuse BSc. IK – v.a. 2022 – 2023* |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Bazuar në takimet e realizuara me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit dhe studentët, GVJ konstaton se përgjatë gjithe zhvillimit të lëndës studentët inkurajohen në procesin e të nxënit nëpërmjet detyrare, pyetje-përgjigje, apo edhe detyrën e kursit/ projektin të realizuar në vazhdimësi. |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Bazuar ne takimet e realizuara me stafin akademik te angazhuar ne programin e studimit dhe studentet, GVJ konstaton se gjate provimit studentet nuk lejohen te perdorin materiale, te cilat inkurajojne kopjen apo thyerjen e rregullave.<br>Në lidhje me temat e diplomave, udhëheqësi garanton shmangien e plagjaturës gjate kontrolleve që në momentin e përzgjedhjes së temës dhe gjatë gjithë periudhës së punës.<br><br>*Referenca:*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019, Neni 22, fq.16*<br>*3.5.b Shembull Procedurë Diplome BSc. IK – v.a. 2021 – 2022.* |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar si edhe vizitave të realizuara në institucion, GVJ konkludon se testimet korigjohen nga pedagogu titullar i lëndës brenda një afati 7 ditor nga dita e zhvillimit të provimit. Studentët njoftohen për rezultatet nga ana e sekretarise mësimore, si edhe nëpërmjet sistemit Pitagora në mënyre individuale. Nota përfundimtare është rezultat i vlerësimit të marë në provimin e ndërmjetëm dhe atë përfundimtar, angazhimit në orët e ushtrimeve/ laboratorëve si edhe detyrës së kursit.<br><br>*Referenca:*<br>*3.6 Format kerkese per rishikimin e tezes*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019, Neni 23, pika 1, fq.17* |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Bazuar në dokumentacion dhe vizitat e realizuara, GVJ konstaton se studenti njihet me vlerësimin e tezës të realizuar nga pedagogu. Nëse studenti vëren se ka pyetje të pavlerësuara, ose të vlerësuara sipas tij në mënyre jokorrekte ai/ ajo ka të drejte të reklamoje vlerësimin nëpërmjet një kërkese që e depoziton në sekretarine mësimore përkatese brënda 48 orëve nga njohja me rezultatin.<br><br>*Referenca:*<br>*3.6 Format kerkese per rishikimin e tezes*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019, Neni 23, pika 3, fq.* |

<table>
<tr><td>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</td><td colspan="4">Bazuar në dokumentacion GVJ konkludon se pas reklamimit të provimit nga ana e studentit për arsyet e sipërpërmendura. Dekani i Fakultetit përkatës formon një komision ad hoc, ku përfshihen edhe pedagogët që kanë korrigjuar provimet. Vendimi për rivlerësimin e provimit merret brenda një jave nga dorëzimi i ankesës dhe njoftohet studenti përmes sekretarisë mësimore. Vendimi i bashkëlidhet proces-verbalit të provimit.<br><br>Referenca:<br>H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019, Neni 23, pika 4-5-6, fq.17</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">GVJ arrin në përfundimin se Institucioni dhe njësia përgjegjëse zbaton të gjitha procedurat e nevojshme për të garantuar një proces vlerësimi të drejtë duke përfshire këtu edhe procesin e ankimit të vlerësimit nga ana e studentëve. Rekomandojme se proces-verbalet duhet të gjenerohen elektronikisht, duke evituar shkrimin e tyre me dore për të rritur transparencën në procesin e vleresimit.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi III.4<br>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</td><td>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike” është i strukturuar në tre vite akademike. Bazuar në strukturën e programit mësimor mund të themi se: Gjate vitit të parë akademik, programi ka si synimin të ofroje njohuri të përgjithshme të mbështetura në lënde të formimit baze të karakterit shkencor. Ndërkohe që gjatë 2 viteve të tjera akademike, programi ndryshon karakter duke pasur si qëllim vendosjen e lëndëve që përkojnë me profilin e diplomës, “Inxhinieri Kompjuterike”.<br>Vlen për t'u theksuar se qëllimi i kësaj kurrikule është t'u ofrojë studentëve njohuri, të cilat do të jenë të nevojshme edhe për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit dhe në të njëjtën kohë t'u përgjigjet kërkesave me të cilat do të përballen studentët gjatë realizimit të tyre profesional.<br><br>Referenca:<br>2.1.a Kurrikula BSc. IK – 04.2019<br>2.1.b Plani mesimor BSc. IK - 04.2019</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. | Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" është një program i formimit inxhinierik që ofron njohuri në fushën e teknologjisë së informacionit, në përputhje me profilin përkatës. Gjatë vitit të parë, studentët ndjekin lëndën "Gjuhë e huaj" me 4 ECTS, me qëllim të thellimit të njohurive në gjuhën angleze dhe pasurimit të fjalorit me terminologji teknike të profilit inxhinierik. Detyrat e kursit gjatë gjithë ciklit Bachelor nxisin krijimin e aftësive komunikuese dhe ndërvepruese të studentëve, duke i përgatitur ata për të prezantuar projektet e tyre përmes raporteve dhe prezantimeve publike.<br><br>*Referenca:*<br>*2.1.a Kurrikula BSc. IK – 04.2019*<br>*2.1.b Plani mesimor BSc. IK - 04.2019* |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. | Pedagoget përgjegjes për programin e studimit verifikojnë kompetencat dhe aftësite që fiton studenti në përfundim të lëndës mësimore. Kjo mundëshohet nëpërmjet kontrollit të detyrave të kursit, puneve të laboratorit të cilat dorezohen nga studentet gjate oreve të fundit të mësimit. Në shumicën e lëndeve pedagoget realizojne dhe testime të pjesëshme.<br>Në fund të çdo semestri, stafi akademik harton raportin semestral, në të cilin raporton për realizimin e objektivave të mësimdhënies.<br><br>*Referenca:*<br>*2.1.a Kurrikula BSc. IK – 04.2019*<br>*2.1.b Plani mesimor BSc. IK - 04.2019*<br>*3.7.a Shembull raporti semestral PAE - BSc.*<br>*3.7.b Shembull raporti semestral PAK - BSc.* |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e | Bazuar në kurrikulën e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" mund të themi se ajo është hartuar në mënyre të tille që tu japë studentëve mundësi të zhvillojne njohurite e marra në laboratore dhe praktika profesionale. Temat laboratorike janë në përputhje me temat e leksioneve dhe seminareve. Të njëjtën gjë mund të themi dhe për praktikën profesionale.<br>Nga vizita në institucion u verifikua se në disa tema dhe detyra kursi jepen në formë të tillë që të stimulojnë punën në grup. Sipas pedagogëve përgjegjës qëllimi kryesor është të nxitin punën në grup aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve si dhe diskutimin e tyre.<br>Po ashtu, në takimet me personelin akademik, studentet dhe drejtuesi i njësisë bazë e kryesore, rezulton se stafi akademik përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" mbështet implementimin e ideve inovative, gjatë detyrave të kursit, diplomave dhe nxit pjesëmarrjen e tyre në konferenca studentore. Bazuar në pajisjet laboratorike si dhe në stafin mësimdhënës studentët realizojnë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | eksperimente dhe pune inovative, nën mbikqyrjen e pedagogut, të cilat publikohen dhe në revista shkencore.<br>Nga vizita në institucion u verifikua se, Departamenti i Inxhinierive, përgjegjës për programin mësimor ka mundësuar mobilitetin në nivel kombëtar dhe ndërkombetar me qëllim shkëmbimin e eksperiencave me institucionet partnere.<br><br>*Referenca:*<br>*3.9.a Poster Forumi Studentor "Transformimi digjital në kohën e sfidave" + lista pjesëmarrës – 17.05.2021*<br>*3.9.b Programi Forumi II Studentor "Transformimi digjital në kohën e sfidave" - 17.05.2022* | | | |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Nga vizita ne institucion dhe takimet me studentet dhe personelin akademik u njohem me eksperiencat e tyre mbi bisedime te hapura midis personelit akademik dhe studenteve mbi eksperienca e secilit me teknologjite e reja ne fushen perkatese. | | | |
| **Konkluzione** | *Pasi grupi i punës shqyrtoi të gjitha kriteret dhe vleresoi me përpikmëri të gjitha pika e lartpërmenduara, konkludon se ky program studimi ka në përbërje të tij elementët e nevojshëm për përfitimin e duhur të njohurive dhe një strukturim të përshtatshëm.*<br>*GVJ vlereson se ky kriter plotësohet plotësisht.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën | GVJ bazuar në dokumentacion konstaton se është përgjegjësi e njësisë bazë, që informon studentët në lidhje me procedurat e duhura për diplomimin në këtë program studimi. Pasi kanë përmbyllur të gjithë detyrimet përkatëse për të gjithë lëndet prezente ne kurrikul, studentet duhet ti nenshtrohen provimit final te formimit. Nëse studentët kanë një mesatare mbi notën 8, atëhere ata kanë të drejte të realizojne një teme diplome nese deshirojne në vend të provimit të formimit.<br><br>*Referenca:* |

| | |
|---|---|
| studentit për punim diplome dhe e bën atë publike. | *H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019, Neni 29, fq.19-20* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | Nga dokumentacioni dhe vizita në Institucion, GVJ konstaton se fondi i pyetjeve për provimin përmbyllës të diplomimit të hartuara nga pedagogët e lëndëve përkatëse ju vihet në dispozicion studentëve. Zgjidhja e tyre bëhet gjatë zhvillimit të lëndës. Përsa i përket temës së diplomes, studenteve i vihet në dispozicion materiali pershkrues per realizimin e punimit te temes, që nga perzgjedhja deri në prezantimin përfundimtar.<br><br>*Referenca:*<br>*3.10.a Pyetjet e provimit të formimit BSc. IK + TI - v.a. 2021 – 2022*<br>*3.5.a Procedurë Diploma Bachelor – v.a. 2021 - 2022*<br>*3.5.b Shembull Procedurë Diplome BSc. IK – v.a. 2021 – 2022* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, GVJ konkludon se provimi perfundimtar permbylles i diplomimit perbehet nga pyetje te perzgjedhura te fondit total te pyetjeve. Pyetjet jane nga lende te caktuara, ku eshte percaktuar edhe pesha qe ato zene ne provimin perfundimtar.<br><br>*Referenca:*<br>*3.10.b Shembull teze provim formimi BSc. IK + TI - v.a. 2021 - 2022* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | GVJ konstaton se udheheqesi i temes se diplomes, perpos percaktimit te temes e ka te detyrueshme te keshilloje/orientoje studentin gjate gjithe etapave te punes ne realizimin e temes deri ne prezantimin final te saj. Nga ana tjeter, njesia baze publikon nje grafik me afatet kohore per te realizuar kontrolle te diplomes gjate periudhes pergatitore te saj, te cilat studenti i ka te detyrueshme ti kryeje.<br><br>*Referenca:*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019, Neni 29, fq.20*<br>*3.5.a Procedurë Diploma Bachelor – v.a. 2021 - 2022*<br>*3.5.b Shembull Procedurë Diplome BSc. IK – v.a. 2021 – 2022* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | GVJ bazuar në vizitat e realizuara në Institucion konkludon se njesia baze vë në dispozicion për kryerjen e matjeve, analizave, testeve te ndryshme qe u duhen studenteve te gjithe infrastrukturen e tij laboratorike, si edhe amjentet e punes te kompanive, institucioneve me te cilat kane bashkepunim. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | GVJ konstaton se ne përfundim të detyrimeve përmbyllëse si provim përfundimtar ashtu edhe teme diplome studenti vleresohet me notë, e cila pasqyrohet në listen e notave që bashkëshoqëron diplomën në përfundim të studimeve.<br><br>*Referenca:*<br>*E.3 Lista e notave dhe suplement - BSc. IK* |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të studimeve, studenti, i cili ka përfunduar me sukses të gjitha lëndët e programit të studimit dhe ka përmbushur të gjitha detyrimet e parashikuara në programin e studimit, pajiset me diplomë Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, të Universiteti Privat "Albanian University" referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.<br><br>GVJ sipas dokumentacionit të dorezuar arrin në perfundimin se në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MASR.<br><br>*Referenca:*<br>*E.3 Lista e notave dhe suplement - BSc. IK* |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | GVJ konstaton se Institucioni ruan të dhënat e studentëve të diplomuar, të cilat përdiësohen periodikisht si rrjedhoje e shtimit të studenteve te diplomuar. Dokumentacioni origjinal i studenteve te diplomuar ruhet sipas legjislacionit ne fuqi. Informacione ne lidhje me punesimin e tyre pas diplomimit gjithashtu Institucioni bën përpjekje të vazhdueshme për ti pasur dhe për ti përpunuar ato edhe në nivel statistikor.<br><br>*Referenca:*<br>*Takime ne Institucion* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.*<br>*Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kritere të tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar formimi. Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi IV.1<br>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</td><td>GVJ pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e dorezuar, si edhe viziten e realizuar ne Institucion konstaton se njesia pergjegjese duhet te beje perpjekje per rekrutime te reja me grada shkencore minimalisht Doktor per te garantuar nje mesimdhenie efektive dhe shperndarje racionale te ngarkeses mesimore me numrin e studenteve ne rritje.<br>Aktualisht verejme se ka staf me background master shkencor, te cilat jane te mbingarkuar me lende te tipologjive te ndryshme per kete program studimi.<br>Raporti personel akademik efektiv/personel akademik me kontrate i cilësise se stafit të angazhuar prane Departamentit të Inxhinierive për programine e studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike"<br>është si më poshtë vijon:<br><br><u>Stafi akademik i programit të studimit:</u>
<table>
<tr><td rowspan="2">Tituj/grada</td><td>2022-2023</td><td>2021-2022</td><td>2020-2021</td></tr>
<tr><td>PAE/PAK</td><td>PAE/ PAK</td><td>PAE/ PAK</td></tr>
<tr><td>Prof.Dr</td><td>0/0</td><td>0/0</td><td>0/0</td></tr>
<tr><td>Prof.As.Dr</td><td>2/3</td><td>2/4</td><td>1/4</td></tr>
<tr><td>Dr/PhD</td><td>5/10</td><td>5/9</td><td>6/6</td></tr>
<tr><td>Msc</td><td>8/ 1</td><td>9/1</td><td>7/3</td></tr>
<tr><td>Në total</td><td>15/14</td><td>16/14</td><td>14/13</td></tr>
</table>
<br>Referenca:<br>Tabela aneks RVB - BSc. IK<br>4.1.e Ngarkesa mësimore stafi akademik BSc. IK - v.a. 2022 – 2023<br>4.2 CV stafi akademik BSc. IK - v.a 2022 - 2023</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë</td><td>Nga dokumentacioni i dorëzuar vërejme se ka personel PAE, të cilet kanë një ngarkesë mësimore mbi normën e lejuar të orëve shtesë për</td></tr>
</table>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al




| | |
|---|---|
| ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | vitin akademik 2022-2023. Si më sipër cituar nga ana e GVJ njësia përgjegjëse duhet të bëje rekrutime të reja për ta bëre me racionale ngarkesën mësimore të stafit.<br><br>*Referenca:*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK* |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | GVJ konstaton se dosjet e personelit akademik jane te ruajtura ne menyre korrekte duke perfshire ketu kontratat e punes se bashke me elementet perberes sipas legjislacionit ne fuqi. Insitucioni garanton nepermjet mekanizmave te brendshme kontrollin e prezences se personelit akademik ne pune, mbi te cilin bazohet perpilimi i listprezences dhe me pas pageses se tyre. Bazuar ne intervistat e realizuara me stafin e angazhuar në këtë program studimi GVJ konludon se Institucioni është i rregullt në pagesa dhe derdhjen e sigurimeve shoqërore sipas legjislacionit në fuqi.<br><br>*Referenca:*<br>*4.3.a Kontratë PAE*<br>*4.3.b Kontratë PAK* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | GVJ konstaton se ne fillim te procedures se rekrutimit percakohen kriteret e perzgjedhjes se kandidateve potenciale nga njesia pergjegjese. Nga dokumentacioni i shqyrtuar verejme se Institucioni duhet te permiresoje procedurat e perzgjedhjes ne rekrutimin e stafit te ri, duke perfshire ketu simulimin e një orë mësimore dhe një sistemi pikezimi në renditjen e kandidateve ne percaktimin e kandidatit fitues.<br><br>*Referenca:*<br>*R.1.a Procedurë rekrutimi fillimi i vitit akademik 2021 - 2022.*<br>*R.1.b Procedure rekrutimi para fillimit te Sem. II - v.a. 2021 - 2022*<br>*R.1.c Procedurë rekrutimi fillimi i vitit akademik 2022 – 2023.*<br>*R.1.d Procedurë rekrutimi para fillimit të semestrit të dytë – v.a. 2022 – 2023*<br>*1.6 Rregullore FSHAE - 20.04.2022, Neni 19, pika 9, fq.10 - 11* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, | GVJ konstaton se prane njesise pergjegjese eshte i angazhuar staf ndihmes akademik me pergatitje te pershtatshme per mbikqyrjen dhe mirembajtjen e laboratoreve dhe mjediseve mesimore.<br><br>*Referenca:*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK, Tabela 2* |

| | |
|---|---|
| sipas natyrës specifike të programit të studimit. | |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | GVJ veren se Institucioni perediteson te dhenat e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit te pakten nje here ne vit. Keto te dhena te reja ruhen ne dosjet perkatese te personelit prane zyres se burimeve njerezore si dhe prane njesise baze. |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Bazuar ne dokumentacionin e dorezuar verejme se Institucioni ka mareveshje bashkepunimi me institucione e kompani per te realizuar praktikat mesimore. Njesia baze cakton 1 pedagog mbikqyres per cdo student per te monitoruar punen e tij gjate praktikes mesimore, sigurisht edhe punimit te diplomes. Nje pedagog ka nen mbikqyrje jo me shume sesa 20 studente.<br><br>*Referenca:*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK, Tabela 5*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019, Neni 27, fq.19* |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | GVJ konstaton se ne insitucionet/kompanite/bizneset ku Institucioni dergon studentet per realizimin e praktikave mesimore ka personel te angazhuar per te ndihmuar studentet ne perpmbushjen e deyrimeve te praktikes si edhe ne pergatitjen e raportit perfundimtar.<br><br>*Referenca:*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK, Tabela 5*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se njesia pergjegjese duhet te beje perpjekje per rekrutime te reja me grada shkencore minimalisht Doktor per te garantuar nje mesimdhenie efektive dhe shperndarje racionale te ngarkeses mesimore me numrin e studenteve ne rritje. Institucioni duhet te permiresoje procedurat e perzgjedhjes ne rekrutimin e stafit te ri, duke perfshire ketu simulimin e një ore mësimore dhe një sistemi pikezimi në renditjen e kandidateve në percaktimin e kandidatit fitues.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Aktiviteti mesimor per programin e studimit Bachelor ne Inxhinieri Komjuterike zhvillohet ne godinen e Rrugen se Kavajes. Aty jane alokuar auditoret mesimdhenese, laboratoret dhe biblioteka. Ndertesa eshte e madhe, e rikonstruktuar ne te gjitha ambientet e saj, me salla leksionesh, seminaresh dhe laboratore ne funksion te fushave specifike te ndryshme inxhinierike te ofruara. Ndricimi eshte i pershtatshem dhe hapsirat per levizjen e njerezve jane me se te mjaftueshme.<br>Institucionin ka ne dispozicion ambjente te dedikuara si dhe instrumenta te nevojshem (kompjuter, lidhje internet, kancelari, etj) per kryerjen e aktiviteteve mesimore dhe administrative. Ambjentet e mesimdhenies jane te pajisura me te gjitha mjetet e nevojshme didaktike. Ambjentet janë të hapura dhe të aksesueshme nga i gjithë personeli akademik.<br><br>*Referenca:*<br>*4.5 Planimetrite - Godina e Rr. Kavajes - 2020* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive | Të gjitha sallat janë të pajisura me orendi të përshtatshme për zhvillimin e mësimit dhe me mjetet e nevojshme teknologjike: kompjuter, videoprojektor etj, në funksion të mbarevajtjes së mësimdhënies. E gjithe godina mbulohet nga rrjet interneti wireless, e disponueshme për të gjithë.<br>Po ashtu nga vizita qe GVJ beri ne institucion vizitoi po ashtu edhe laboratoret te cilet duhet thene se ishin te pajisur me teknologji te avancuar dhe me ambiente te bollshme. |

| | |
|---|---|
| bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | *Referenca:*<br>*1.5 Përshkrimi i Laboratoreve të Departamentit të Inxhinierive*<br>*4.5 Planimetrite - Godina e Rr. Kavajes - 2020* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Ne funksion te programit te studimit Bachelor ne Inxhinieri Kompjuterike, te ofruar nga Departamenti i Inxhinierive, jane ngritur 10 laboratoret mesimore, te cilet jane ne sherbim te realizimit edhe te programeve te tjera te studimit qe ofron departamenti ne ciklin e pare dhe te dyte te studimeve.<br>Laboratoret jane te pajisur me aparatura dhe mjete mesimore bashkekohore, te mjaftueshme ne numer per kryerjen e oreve laboratorike. Laboratoret, jane te disponueshem per studentet gjate oreve te mesimit, per pergatitjen e detyrave te kursit, diplomave apo studimeve te tjera nga ana e tyre, nen kujdesin e personelit pergjegjes per laboratoret.<br><br>*Referenca:*<br>*1.5 Përshkrimi i Laboratoreve të Departamentit të Inxhinierive* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Prane departamentit te Inxhinierise funksionojne dy laboratore te informatikes:<br>• Laboratori i Informatikes 1<br>• Laboratori i Informatikes 2 (Simulimeve)<br>Ne Laboratorin e Informatikes 1, kompjuterat kishin parametra te pershtatshme per te suportuar software ne versionet e tyre me te fundit, ne perputhje me programet lendore.<br>Laboratori i Informatikes 2 eshte pajisur me programe (simulime) te nevojshme ne ciklin e pare dhe te dyte te studimeve ne fushat inxhinierike, te cilat jane te perditesuara.<br><br>*Referenca:*<br>*1.5 Përshkrimi i Laboratoreve të Departamentit të Inxhinierive* |
| **Konkluzione** | *GVJ vlereson se institucioni i arsimit te larte ve ne dispozicion mjedise mesimore dhe infrastrukturen e pershtatshme per realizimin e procesit mesimdhenes te programit te studimit dhe per formimin praktik, te posacme sipas natyres dhe fushes se programit te studimit. Si perfundim vleresojme se ky kriter permushet plotesisht.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Standardi IV.3**

**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, GVJ vëren se titujt e përzgjedhur në literaturën e huaj, si edhe leksionet e hartuara ne shqip jane te pershtatshme per lendet dhe temat e zhvilluara ne syllabuset perkatese. Kopje të tyre fizike mund të gjenden prane Bibliotekes se Institucionit. Literatura mund të aksesohet nëpërmjet librave fizikë që disponohen në bibiotekë, por edhe në rrugë digjitale.<br><br>*Referenca:*<br>*R.4 Syllabuse BSc. IK – v.a. 2022 – 2023* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | GVJ vëren se bazuar në përditësimet e syllabuseve, cdo fillim viti akademik, njësia baze bën kërkesë për shtimin e titujve në bibliotekë. Kjo vërehet duke pare modifikimet e bëra në silabuse vit mbas viti në seksionin e literatures së përdorur. Gjatë takimeve me përgjegjësen e departamentit dhe pedagogët, u pohua se çdo fillim viti akademik, titullari i lëndës dorëzon programet lëndore ku jepen detaje mbi literaturën e detyruar bazë dhe të rekomanduar e cila duhet të jetë e përditësuar me botime bashkëkohore.<br><br>*Referenca:*<br>*2.7.a Rishikime syllabuse - v.a. 2018 - 2019*<br>*2.7.b Rishikime syllabuse - v.a. 2019 - 2020*<br>*2.7.c Rishikime syllabuse - v.a. 2020 - 2021*<br>*2.7.d Rishikime syllabuse - v.a. 2021 - 2022*<br>*2.7.e Rishikime syllabuse - v.a. 2022 - 2023*<br>*2.8 Kërkesë pasurimi i bibliotekës v.a. 2021 - 2022.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Institucioni zotëron Bibliotekën në të njëjtën godine ku studentët për këtë program studimi zhvillojne mësim, në një hapesire të përshtatshme ku përvec hapesirës për libra gjendet edhe 25 terminale të lidhura me një kompjuter qëndror.<br><br>*Referenca:*<br>*4.5 Planimetrite - Godina e Rr. Kavajes - 2020* |
| Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të | Literatura e ofruar është në formë fizike (hardcopy), format elektronik dhe online, duke mundësuar realizimin me sukses të projekteve kërkimore-shkencore të kërkuara nga pedagogët në kuadër të mësimdhënies dhe përgatitjen e tezës së diplomimit. Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ofron studentëve 120 tituj librash në fushat inxhinierike, me gjithsej 398 kopje. Më shumë se 80% e literaturës së detyrueshme në gjuhën shqipe, e |

| | |
|---|---|
| mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | përcaktuar në syllabuset e lëndëve, është e disponueshme në bibliotekë. Këto libra janë të disponueshëm në kopje të mjaftueshme dhe në edicionet më të fundit.<br><br>*Referenca:*<br>*R.4 Syllabuse BSc. IK – v.a. 2022 – 2023*<br>*4.6 Lista e librave në bibliotekë - 2022* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | GVJ vëren se në dispozicion të studentëve janë vënë një seri librarish online, të cilat janë të aksesueshme nën kujdesin e punonjëses së bibliotekës në qëndrën e internetit.<br>Librarite online të këshilluara janë me drejtim kryesisht inxhinierik.<br><br>*Referenca:*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK, Tabela 17* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Pas vizitës së realizuar në Institucion GVJ konstaton se në ambjentet e Bibliotekës janë të instaluar 25 terminale të lidhura me një kompjuter qëndror, të cilat i japin mundësi studentëve të lidhen në internet dhe akses në libraritë online.<br><br>*Referenca:*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK, Tabela 17* |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Oraret e aksesit të Bibliotekës janë nga e Hëna në të Premte ora 08.00-16.00, si edhe të Shtunën nga ora 08.00-12.00. GVJ kontaton se ambjentet dhe oraret e Bibliotekes janë të përshtatshme për numrin e studentëve në këtë program studimi dhe kohën, të cilën ata kalojnë në Universitet. |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave | Departamenti mban kontakt të vazhdueshëm me punonjësen e bibliotekës së Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, për të monitoruar përdorimin e fondit të bibliotekës nga studentët dhe stafi akademik, si dhe për të ndjekur nevojat e vazhdueshme për përditësim dhe pasurim të materialeve të bibliotekës.<br>GVJ rekomandon edhe përpilimin e një raporti periodik për të pasqyruar të gjithë këtë proces. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton ky standart përmbushet plotësisht duke garantuar ambjente, infrastrukturë, orare dhe tituj librash të përshtatshëm për studentët. Të gjithë studentët kishin akses të barabartë në burimet fizike dhe online të bibliotekës.*<br>*Studentët pohuan që orari i bibliotekës është i përshtatshëm për të përballuar nevojat e tyre dhe për të mos ndikuar tek mbarëvajtja mësimore.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Sekretaria mësimore është përgjegjëse për ruajtjen, menaxhimin dhe përditësimin periodik të të dhënave të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim. Sekretaria mësimore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përbëhet nga një kryesekretare, 2 sekretare për programet e studimit të ciklit të parë dhe 1 sekretare për programet e studimit të ciklit të dytë.<br>"Albanian University" disponon sekretarine online (Sistemin Pitagora). Cdo student ka llogarine e tij, ku mund të logohet me kredencialet personale dhe të marrë informacionin personal në lidhje me të dhënat e tij të përditësuara, rezultatet e arritura, lëndët të cilat duhet të frekuentojë etj.<br>Në vizitën e kryer në sekretari, u pa regjistri themeltar, regjistri i notave, disa procesverbale notash dhe procesverbali i ndërmjetëm. Regjistri themeltar ishte i plotesuar, të gjithë studentet ishin pajisur me numër matrikulimi. Nuk u gjetën parregullsi në hedhjen e rezultateve të studenteve nga procesverbalet në regjistrin e notave. Dosjet e studenteve ishin të plota. Dosjet e transferimit të studenteve ishin të plota.<br><br>*Referenca:*<br>*Vizita ne Institucion* |

| | |
|---|---|
| | *https://albanianuniversity.edu.al* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.<br>**Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Informacionet qe lidhen me aktivitetin e personelit akademik efektiv dhe me kontrate si dhe atij ndihmes akademik ruhen ne Departament dhe ne Zyren e Burimeve Njerezore.<br>Ne takimin e bere me zyren e burimeve njerezore, u verifikuan 2 dosje personale te personelit akademik efektiv. Dosjet u perzgjodhen ne menyre rastesore. Dosjet ishin te plota, me te gjithe informacionin dhe te dhenat personale te personelit: CV, ID, diplomat e kualifikimit, libreza shendetsore, raporti mjeko-ligjor, libreza e punes, kontrata e angazhimit, aneks kontrate. Ne pergjithesi rezulton qe personeli akademik efektiv dhe me kontrate eshte i angazhuar ne mesimdhenje brenda fushes se tyre te kompetences.<br>Informacionet lidhur me partneret e angazhuar ne realizimin e programit: universitetet partnere, kompanite ku kryhen praktikat, institucione te tjera te kerkimit, etj., ruhen ne Departament dhe ne zyrat perkatese: Zyra e Koordinimit dhe Mbeshtetjes Per Studentet, Zyra e Marredhenieve me Jashte, Zyra e koordinimit të Kerkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike etj. në funksion të fushes së bashkepunimit.<br>Studentet përmes Sekretarise Online (Sistemi Pitagora) mund të aksesojnë në kohë reale të dhenat e tyre të përditesuara, rezultatet e arritura, lëndët, të cilat duhet të frekuentojnë etj.<br>Informimi i personelit akademik realizohet nëpërmjet mbledhjeve, emaileve, website, platformes Microsoft Teams.<br><br>*Referenca:*<br>*Vizita ne Institucion*<br>*https://albanianuniversity.edu.al* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | Stafi akademik, ai administrativ dhe studentët disponojnë email-et zyrtare të Institucionit, bashkë me të cilët ofrohet paketa Microsoft Teams.<br>Aplikacionet e kësaj pakete mundësojne ruajtjen dhe shpërndarjen e informacionit, si dhe komunikimin interaktiv në kohe reale ndërmjet përdoruesve.<br><br>*Referenca:*<br>*Vizita ne Institucion*<br>*https://albanianuniversity.edu.al* |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të | Platformat e përdorura mundësojnë monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ si dhe bën të mundur që të gjenerohen raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për drejtuesit.<br>Sistemi i menaxhimit siguron monitorimin e mësimdhënies dhe të realizimit të aktiviteteve të tjera formuese edhe gjatë zhvillimit të |

| | |
|---|---|
| dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | mësimit në auditor apo gjatë procesit të kryerjes se praktikave dhe punimeve të diplomave.<br>Personeli akademik harton një raport semestral në lidhje ecurine dhe problematikat e dala gjatë zhvillimit të mësimit.<br><br>*Referenca:*<br>*Vizita ne Institucion*<br>*https://albanianuniversity.edu.al* |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Ne faqen web të Institucionit (https://albanianuniversity.edu.al/) jepen informacione lidhur me programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Inxhinierive, aktivitetet e ndryshme të zhvilluara nga Institucioni, të cilat jane ne azhornim te vazhdueshem etj.. Faqja web është e ndërtuar në dy gjuhe shqip dhe anglisht.<br><br>*Referenca:*<br>*Vizita ne Institucion*<br>*https://albanianuniversity.edu.al* |
| **Konkluzione** | *GVJ vëren se institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brëndshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Si përfundim vlerësojme se ky kriter përmushet plotësisht.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | GVJ bazuar ne RVB konstaton se "Albanian University", si pjese e Shoqerise UFO sh.p.k, perfiton fondet e nevoshme bauar ne programin financiar afatmesem per nje periudhe kohore 3-vjecare, i cili realizohet duke mare parasysh te gjithe shpenzimet dhe nevojat per programet e studimit te ofruara nga ky Institucion.<br>Ligji Nr. 80/2015 "Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne Republiken e Shqiperise", Ligji Nr. 9901, dale 14.4.2008 "Per Trcgtarct dhe Shoqerite Tregtare", ne Ligjin Nr. 9228. date 29.4.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", akteve te tjera nenligjore ne zbatim te tyre, dhe aktet normative te "Albanian University" jane referenca per hartimin e buxhetit ne menyre korrekte.<br>Bordi i Administrimit vendos mbi afatet kohore dhe rregullat e hartimit te buxhetit dhe me pas ja percjell ato organeve drejtuese akademike dhe |

| | |
|---|---|
| | administrative. Njësitë baze dhe njësite kryesore bëjne kërkesat e tyre financiare, të cilat i përcillen Administratorit të përgjithshëm, i cili duke qene edhe anetar i Rektoratit, në bashkëpunim me zyren e finances, harton projekt buxhetin vjetor dhe ate afatmesem tre vjecar. Buxheti vjetor dhe ai afatmesem tre vjecar, kalon fillimisht në Senatin Akademik, i cili bën miratimin e tij paraprak dhe me pas i përcillet Bordit të Administrimit.<br><br>*Referenca:*<br>*RVB*<br>*1.4.a Plani strategjik institucional 2017 - 2022* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | Të gjitha zërat e përmendur më sipër bazohen në nevojat e njësive bazë dhe kryesore, duke përfshirë planin e investimeve dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Këto përfshijnë financimet për burimet njerëzore në shërbim të programeve të studimit, kërkesat për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të kërkuara, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse, si investimet në laboratorin e informatikës, shpenzimet për pasurimin e literaturës dhe bibliotekave online, dhe të gjithë zërat e tjerë të njësisë bazë.<br><br>*Referenca:*<br>*1.4.a Plani strategjik institucional 2017 - 2022* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | Bazuar në RVB, GVJ kontaton se për kryerjen e auditimit, Institucioni kerkon suport nga një kontabel i miratuar dhe i regjistruar, i cili kontrollon dhe certifikon bilancin e cdo viti.<br>Ky raport auditi hartohet për të vleresuar eficencen e perdorimit te te ardhurave, pjesa kryesore e te cilave vijne nga tarifat e shkollimit të studenteve. Raporti i auditimit i hartuar percillet sipas proedurave përkatese në Bordin e Administrimit.<br><br>*Referenca:*<br>*RVB*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK* |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë | Institucioni ka të dokumentuara raportet financiare për tre vitet e fundit, me procedurat që zhvillohen gjatë periudhës mars-maj. Rektorati |

| | |
|---|---|
| përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | përgatit raportin financiar të bazuar në planifikimet e bëra në programin financiar. Ky raport miratohet nga Bordi i Administrimit. Në përfundim të kësaj faze, realizohet edhe një analizë për të planifikuar ndërhyrjet e nevojshme në të ardhmen për mbarvajtjen e programeve të studimit. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | Bazuar ne RVB dhe dokumentacion vleresohet se situata financiare pozitive e Institucionit garanton te gjitha instrumentet financiare te nevojshme per zhvillimin logjistik, burime njerezore per zhvillimin dhe permiresimin e ketij programi studimi.<br><br>*Referenca:*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK/Tabela 18* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Institucioni garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje | GVJ bazuar në dokumentacion vlereson se Institucioni ka hartuar dokumenta themelore per mirefunksionimin e tij akademik si Rregullorja e Universitetit, ku rregullohet veprimtaria e organeve kryesore administative, legjislative e njesite baze. Rregullorja e fakultetit dhe rregullorja e programit te studimit rregullon te gjitha |

| | |
|---|---|
| me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | procedurat per te mbuluar ne menyre te plote te gjithe veprimtarine akademike te studenteve për të gjithe vitet e studimit per ciklin e studimit.<br><br>*Referenca:*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019*<br>*1.6 Rregullore FSHAE - 20.04.2022*<br>*1.3 Rregullore Albanian University* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje të zbatuara nga Institucioni garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë studentët nga fillimi deri në përfundim të studimeve për këtë program studimi. |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | GVJ konstaton se për përzgjedhjen e studenteve te rinj per te gjitha programet e studimit bachelor që ofron Departamenti i Inxhinierive aplikohet formula e mëposhtme:<br><br>• Mesatarja e përgjithshme 70%,<br>• Mesatarja e gruplendeve 30%,<br>• Informatike 10%<br>• Matematike 10%<br>• Fizike 10%<br><br>Mënyra e përzgjedhjes së studenteve për cdo vit akademik dërgohet në MASR sipas afateve të kërkuara nga kjo e fundit. Në programet Bachelor janë parashikuar edhe kuota për studente të huaj.<br><br>*Referenca:*<br>*2.5 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve - VS 25 - dt. 25.06.2020, Neni 13, fq.6* |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Ne rregulloren mesimore te programit te studimit jcpen informacione mhi kritcrct dhc procedurat e pranimit te studentcvc. Ne rregulloren e Regjistrimeve dhe Transfcrimeve jepen informacione te detajuara per njohjen e plote ose te pjesshhme te studimcvc te meparshme.<br>GVJ konstaton se keto informacione vihen ne dispozicion nga strukturat perkatese, te cilat jane te disponueshme edhe per sqarime te metejshme.<br><br>*Referenca:*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019* |

| | |
|---|---|
| | *2.5 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve - VS 25 - dt. 25.06.2020* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Nga vizitat e kryera ne Institucion, GVJ konstaton se informimi i maturanteve ne lidhje me kriteret e pranimit per programin e studimit, ndodh nepermjet mediumeve te ndryshme te komunikimit duke filluar nga pjsemarrja ne ditet e informimit te realizuara nga MASR, dhe me pas me vizitat në Insitucion ku jepen informacione të mëtejshme sipas interesit te tyre. Informacione ne lidhje me kriteret e pranimit, maturantet mund te marin edhe nepermjet faqes web te Institucionit; https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit/<br><br>*Referenca:*<br>*https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit/*<br>*RVB*<br>*Vizite ne Institucion* |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | "Albanian University" perpara fillimit te cdo viti akademik miraton kriteret dhe kuota ku perfshihen edhe kategorite e kandidateve me aftesi te vecanta te pakicave, kandidateve nga trojet dhe shtresat e margjinalizuara. Per vitin akademik 2022-2023, me Vendimin e Senatit Akademik Nr. 4, date 09.03.2022, jane miratuar 7 kuota per studente me statusin e jetimit, 3 kuota, për persona me aftesi ndryshe, 1 kuote për komunitetin rom dhe ballkano - egjiptian , 69 kuota për studentët që vijnë nga trojet. Perzgjedhja e kandidatëve fitues bëhet në përputhje me kriteret e përgjithshme të miratuara nga Institucioni. |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | GVJ bazuar në intervistat e realizuara në Institucion, konstaton se në hartimin e kritereve për kandidatët për programet e studimit në Institucion, përfshihen të gjitha kategorite duke përfshire këtu edhe kandidatët të huaj. Këto kritere sipas procedurës miratohen nga Senati Akademik dhe përcillen zyrtarisht në MASR sipas afateve të kërkuara prej saj.<br><br>*Referencat:*<br>*RVB*<br>*Vizite ne Institucion* |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | "Albanian University" harton politika për të ndihmuar studentët që i përkasin shtresave në nevoje dhe atyre të kategorive të vecanta. Me propozim të Senatit Akademik dhe miratim të Bordit të Administrimit, përcaktohen kategorite e studentëve, të cilët përfitojne bursa të ndryshme studimi, ku përvec programit të ekselencës, i cili mbështetet në rezultatet e arritura nga studentet, përfshihen edhe kategori të tjera si:<br>Fëmijet e policëve të rënë në krye të detyrës<br>Fëmijet jetime dhe ata të rritur në institucione shtetërore<br>Persona të kategorive të vecanta invaliditeti: |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Studente të komunitetit rom;<br>Studente të propozuar nga Organizata Rinore. | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Institucioni harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | GVJ kontaton nga intervista e realizuar me studentet per kete program studimi se ne fillim te studimeve te tyre kane mare informacion te hollesishem ne lidhje me perparimin e tyre akademik dhe strukturen e programit te studimit. Sipas rregullores se programit te studimit theksojme si me poshte vijon:<br><br>• Studenti, i cili në perfundim të vitit akademik nuk merr 50% të lëndëve (së bashku me sesionin e vjeshtes), nuk kalon në vitin akademik pasardhes, por mbetet në stazh.<br>• Studenti detyrohet të frekuentoje lëndet e të rifutet në sesionet përkatëse të provimit.<br>• Studenti fiton të drejten e mbrojtjes së diplomës (ose provim formimi), nëse ka shlyer të gjitha detyrimet e prapambetura të programit mësimor.<br><br>Në takimin me përfaqesuesit e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studenteve dhe të Zyrës së Karrierës e Alumnit u theksua organizimi i ditëve të informimit, ku studentët marrin informacion në lidhje me rregulloren e programit të studimit dhe kriteret për të kaluar në vitin pasardhës.<br><br>*Referenca:*<br>*Vizite ne Institucion*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të | Në institucion është ngritur dhe funksionon një njësi, Zyra e Transferimeve dhe Ekuivalentimeve të Studimeve, përgjegjëse për transferimin e studimeve. Ajo ka një rol pritës dhe administrues të dokumentacionit. Kjo zyrë bashkepunon ngushte me Departamentin, |

| | |
|---|---|
| mëparshme ose studimeve të pjesshme. | dhe informon studentet e interesuar me procedurat përkatese për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve.<br>Institucioni ka nje Rregullore per Regjistrimet dhe Transferimin e Studimeve, ku jepen kerkesat per dokumentacion dhe procedurat per transferimin e studimeve.<br>Ne takimin me sekretarine mesimore u verifikua procedura e transferimit, ne dosjen e nje studenti te transferuar. Dosja permbante te gjithe dokumentacionin e detyrueshem te parqitur nga kandidati, si dhe vendimet e komisionit Ad-hoc për njohjen e krediteve. Komisioni perbehej nga pedagoge te departamentit.<br><br>*Referenca:*<br>*2.5 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve - VS 25 - dt. 25.06.2020* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Gjate javes së pare të vitit akademik, institucioni organizon ditet orientuese, gjate te cilave, stafi akademik, stafi administrativ si dhe ZKMS (Zyra e Koordinimit dhe Mbeshtetjes per Studentet) janë në dispozicion te studenteve, duke i informuar mbi procedurat e ndryshme qe ndjekin mbarevajtjen e studimeve te tyre, te tilla si kalendari akademik, orari mesimor, frekuentimi, organizimi i klasave, grupeve, ambjentet mesimore etj. Gjate oreve te para te mesimit, gjithashtu, pedagoget njohin studentet me permbajtjen e syllabusit te lendes, ne te cilen perfshihen edhe format e vleresimit konkret per secilen lende.<br><br>*Referenca:*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019*<br>*2.1.b Plani mesimor BSc. IK - 04.2019*<br>*5.4 Rregullore e Zyrës së Kordinimit dhe Mbështetjes për Studentët* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Brenda nje muaji nga data e fillimit te vitit akademik, Pergjegjesi i Departamentit u ben te njohur studenteve, te cilet diplomohen ate vit, programin e provimit te formimit ose te temave te diplomave, me anen e te cilave do te behet vleresimi perfundimtar.<br>Diploma "Bachelor" mund te fitohet duke dhene nje provim te pergjithshem formimi, i cili eshte alternative me mbrojtjen e nje punimi diplome per studentet qe kane mesatare mbi 8.<br><br>*Referenca:*<br>*H.1 Rregullore mesimore BSc. IK - 04.2019*<br>*3.5.a Procedurë Diploma Bachelor – v.a. 2021 - 2022* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe | Institucioni fillon informimin e maturanteve gjate diteve te informimit te organizuara nga MASR, dhe me pas ne vazhdim per kandidatet e interesuar per programet e studimit qe ofron me informacione me te detajuara mbi permbajtjen e programeve te studimit dhe kriteret per pranimin në to. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ veren se institucioni i arsimit të larte ve ne dispozicion te studenteve te programit te studimit, informacion te plote e te hollesishem mbi perparimin akademik, njohjen, vleresimin e dijeve deri ne perfundim te studimeve dhe diplomimit ne ate program. Si perfundim GVJ mendon se kriteri permbushet plotesisht.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Gjate javes se pare te vitit akademik, Institucioni organizon ditet oricntucse gjate te cilavc stafi akademik, stafi administrativ dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbeshtetjes per Studentet (ZKMS) dhe Keshilli Studentor jane ne dispozicion te studenteve, duke i informuar mbi procedurat e ndryshme qe ndjekin mbarevajtjen e studimeve te tyre, te tilla si kalendari akademik, orari mesimor, frekuentimi, organizimi i klasavc, grupeve, ambjcntct mesimore, jeten studentore. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Në vijemesi të vizites re realizuar ne Institucion GVJ konstaton se ne fillim të cdo semestri, studentët njihen nga pedagogët e lëndëve me përmbajtjen e syllabuseve, me organizimin e lëndës në leksione/seminare/ushtrime/laboratore/ detyra kursi, mënyrën e vlerësimit, literaturën e detyruar dhe asaj të rekomanduar.<br><br>*Referenca:*<br>*R.4 Syllabuse BSc. IK – v.a. 2022 – 2023* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | GVJ konstaton se ZKMS dhe ZKA janë dy zyra, të cilat informojnë studentët mbi mundësitë e punësimit, duke organizuar edhe aktivitete të ndryshme orientuese gjatë kërkimit të një pune, realizimit të intervistave të punës etj.<br><br>*Referenca:*<br>*5.1.a Freelancer – Mundësi punësimi – 21 02 2020*<br>*5.1.b Panair pune në Zoom – 28 05 2020*<br>*5.1.c Si te punesohesh - Prof. Dr. Silvana Vishkurti - 17.03.2022* |

| | |
|---|---|
| | *5.2 Informacion mbi mundësinë e punësimit pranë kompanisë Noa Holding* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | GVJ konkludon se informimi i studenteve realizohet gjate diteve të orientimit, ku studentet njihen me të gjithe logjistiken dhe infrastrukturen e Institucionit. Detyre e stafit akademik është të njohe studentët me zhvillimin dhe organizimit e procesit mësimor, dhe elementëve përberës si përmbajtja e syllabusit, temat e lëndes, literatura etj. |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Institucioni vë në dispozicion të studentëve në ambjentët e Universitetit, në sekretarin online, në klasat Microsoft Teams dhe në faqen e tij web, të dhëna mbi orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulava dhe ekstrakurrikulare, si dhe cdo informacion tjetër në funksion të mbarevajtjes së procesit mësimor. |
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon se Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | Në sekretarine mësimore mbahet regjistri i të diplomuarve, në të cilin regjistrohen të diplomuarit në vite sipas programeve të studimit. Në periudhen 2021-2022 jane diplomuar 30 studente, nga të cilët numri i të punësuarve në përputhje me diplomën eshte 5 dhe jo në perputhje me diplomen eshte 7.<br>Një pjese e madhe e studenteve synojne te vazhdojne studimet ne ciklin e dyte. |

| | |
|---|---|
| | *Referenca:*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK* |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Institucioni miremban regjistrin themeltar, ku jane te regjistruar studentet ne vite, si studente te regjistruar per here te pare, ashtu edhe ata te tranferuar nga universitete te tjera. Ne regjister hidhen te gjitha te dhenat ne lidhje me progresin akademik te studenteve, qe nga pranimi deri ne diplomim, ata qe jane larguar apo qe perserisin vitin.<br><br>Viti akademik / Nr. Studenteve te regjistruar per here te pare / Nota mesatare ne hyrje:<br>2018-2019 / 25 / 7.66<br>2019-2020 / 28 / 7.55<br>2020-2021 / 13 / 7.61<br>2021-2022 / 30 / 7.74<br>2022-2023 / 39 / 7.80<br><br>Institucioni mban një regjistër me rezultatet akademike të studentit nga moment i regjistrimit deri në diplomim. Regjistrat ishin të plotesuara në vazhdimësi.<br><br>*Referenca:*<br>*Tabela aneks RVB - BSc. IK* |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Sekretaria mesimore eshte pergjegjese per ruajtjen, menaxhimin dhe perpunimin e te dhenave qe lidhen me studentet. Sistemi i menaxhimit te tyre eshte i sigurte dhe lehtesisht i aksesueshem nga personat e autorizuar. |
